



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport

Mbledhja nr. 45

Prishtinë, më 22.3.2016, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ARSIM, SHKENCË, TEKNOLOGJI,
KULTURË, RINI DHE SPORT**

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, kryetar, Salih Morina, Sergjan Popoviq, Bekim Haxhiu, Shpejtim Bulliqi dhe Mufera Shinik.

Munguan: Ismajl Kurteshi, Teuta Haxhiu dhe Shukrije Bytyçi.

Pjesëmarrës të ftuar: Azem Guri e Alush Istogu, përfaqësues nga MASHT, Valon Kashtanjeva e Feim Hoxha, përfaqësues të MKRS-së, Ardita Zejnullahu - AMPEK, Agron Bajrami – Grupi KOHA dhe Besa Shahini.

Pjesëmarrës të tjerë: përfaqësues të KDI-së, KYC-së, OSBE-së dhe mediat.

Stafi mbështetës i Komisionit: Lule Ymeri dhe Shaip Goxhuli

Mbledhjen e kryesoi, Nait Hasani, kryetar i Komisionit.

**Për këtë mbledhje u propozua ky
rend i ditës:**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 15.3.2016;
3. Shqyrtimi i raportit me rekomandime për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës;
4. Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 05/L-047 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-065, për të drejtat e autorit dhe drejtat e përafërta;
5. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 15.3.2016

Procesverbali nga mbledhja e mbajtur më 15.3.2016, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i raportit me rekomandime për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës

Nait Hasani, kryetar, tha se Komisioni ka bërë monitorimin e zbatimit të Ligjit Parauniversitar në Republikën e Kosovës. Me këtë rast në bashkëpunim me GIZ-in, është përgatitur një raport me rekomandime. Më tej Hasani shtoi se KYC-ja ka bërë një monitorim të shkollave për të parë për së afërmi zbatimin e Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, një monitorim që ka qenë i pavarur nga Komisioni. Ky monitorim është bërë për të parë nivelin e zbatimit të ligjit dhe lidhur me këtë janë nxjerrë këto rekomandime:

I. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë:

1. Të nxjerrë udhëzim administrativ për rithemelimin e Komisionit të Pavarur Shqyrtimin e Materialeve Mësimore në Gjuhën Serbe dhe t'i mandatojë të marrin masa për ndalimin e përdorimit të kurrikulave dhe teksteve shkollore nga Republika e Serbisë që nuk përputhen me Kushtetutën dhe Ligjet e Republikës së Kosovës.
2. Të nxjerrë udhëzimin administrativ për Kodin e Mirësjelljes dhe Masat Disiplinore për nxënësit e nivelit 1 dhe 2 të arsimit parauniversitar.
3. Të publikojë aktet nënligjore në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, dhe vendimet e Ministrit në ueb faqen e Ministrisë, të njëjtat t'iu dërgohen DKA-ve në formë të shkruar dhe elektronike. DKA-të të obligohen që të njëjtat ti përcjellin në të gjitha shkollat.
4. Të ngritë kapacitetet e DKA-ve dhe Shkollave për futjen e të dhënave në SMIA, të obligojë DKA-në të bëjë mbikëqyrjen e shkollave në futjen e të dhënave në SMIA me qëllim të adresimit të çështjeve të veçanta në secilën shkollë.
5. Të ndryshohet Udhëzimi Administrativ nr.16/2012 paisja e nxënësve me tekste shkollore falas, përdorimi dhe ruajtja e tyre, me qëllim të përfshirjes së masave dhe përgjegjësi për të gjithë pjesëmarrësit gjatë blerjes, shpërndarjes dhe pranimi të teksteve mësimore.
6. Të mbledhë nga DKA-të raporte të detajuara për ngarkesat e shkollave me nxënës dhe në bazë të tyre, dhe planet 5 vjeçare që prioritet do të kishin ndërtimin e shkollave në zonat më të ngarkuara urbane. E njëjta të bëhet për shkollat rurale me më pak nxënës (apo klasë të përziera) të cilët do të përfitonin nga transporti, shkollat më të afërta të mëdha dhe ku ofrohet cilësi më e madhe.
7. Të mbledhë nga DKA-të numrin e saktë të braktisjeve të shkollës, si dhe arsyet e braktisjes në nivel shkolle. Pas përmbledhjes së raportit me të dhënat nga të gjitha DKA-të, MASHT-i të hartojë UA që përcakton hapat që DKA-të mund të ndërmarrin në afat të shkurtër për të adresuar braktisjet.

Sa i përket publikimit të akteve nënligjore, dhe vendimeve, është e vërtetë që shumë shpesh këto nuk janë përcjellë deri në nivelin e duhur prej DKA-ve deri në shkollë, por tani me politika të reja të Ministrisë çdo vendim, akt nënligjor dhe Udhëzim Administrativ që publikohet do të kërkojmë prej DKA-ve që të dërgohen në shkollë. Aktualisht janë në finalizim katër Udhëzime Administrative për implementimin e Ligjit të Maturës Shtetërore, dhe këto përveç që do të publikohen në ueb faqe, do të dërgohen edhe në shkollë. Sa i përket kapacitetit të DKA-ve dhe shkollave për futjen e të dhënave në sistemin elektronik SMIA, këtu në bashkëpunim me partnerët zhvillimor është arritur që të përvetësohet sistemi i menaxhimit të informatave në arsim, dhe Ministria është e interesuar që këto të dhëna të jenë kredibile dhe reale pasi mbi bazën e këtyre të dhënave hartohen politikat arsimore. Sa i përket Udhëzimit Administrativ për pajisjen e nxënësve me tekste shkollore, është në procedurë ndryshimi i këtij Udhëzimi.

Alush Istogu, tha se Ministria po synon një decentralizim, duke i fuqizuar më shumë organet e shkollave, Këshillin e Shkollës, si organ qeverisës dhe Drejtorinë e Shkollës, si organ mbikëqyrës.

Sa i përket braktisjes së shkollave, Ministria ka hartuar një program kombëtar. Është formuar grupi punues me rekomandimet për zvogëlimin e braktisjes në shkolle. Këto grupe punuese janë edhe në nivel të DKA-ve, por edhe në nivel të shkollave, duke përfshirë edhe nxënës. Arsimi me të mitur në Qendrat Korrektuese është çështje që është ngritur, kjo është zgjidhur para katër viteve, ku në bashkëpunim me Qendrën Korrektuese të Dubravës, në kuadër të Komunës së Istogut, dhe kjo gjithashtu vlen edhe për mësimdhënësit në Qendrën Korrektuese të Lipjanit Kolizioni i ligjeve mbetet edhe më tutje sfidë për Ministrinë, sidomos Ligji për Shërbimin Civil nuk e përcakton statusin e drejtorit të shkollës. Këtë vit do të fillojë rishikimi i formulës së financimit në arsim, ku në bashkëpunim me GIZ-in dhe LUXdeveolopment do të ndahen profilet e caktuara dhe kostot e buxhetimit.

Çështja e themelimit të Agjencisë është vonuar për shkak të mungesës së buxhetit, ku po shikohen mundësitë e themelimit të kësaj Agjencie me zyrtarë nga Ministria në kuadër të divizioneve të ndryshme. Ministria është në fazën përfundimtare të kurrikulave, ndërsa procesi i pilotimit pritet të përfundojë gjatë këtij viti dhe prej vitit të ardhshëm 2017-2018, do të nisim me zbatimin e kurrikulës në nivelin parafillor.

Këshilli Shtetëror i Licencimit është ndryshuar me zgjedhjen e kryetarit të ri, janë shumë dinamikë në punë dhe mbajnë takime të rregullta.

Ngritja në karrierë e mësimdhënësve do të bëhet në vlerësim të performancës. Ministria ka themeluar Këshillin Shtetëror për Arsimin Parauniversitar, dhe janë mbajtur katër takime deri më tani dhe është në proces të aktiviteteve të mëtutjeshme.

Nait Hasani, ngriti çështjen e mungesës së informimit të nxënësve për ekzistimin e mekanizmave ligjorë, për vijueshmërinë e mësimi praktik, ku mësimdhënësit nuk i informojnë nxënësit për mësimin praktik, pasi sipas të gjeturave të raportit nga KYC-ja vetëm 32% e nxënësve janë në dijeni për ekzistimin e këtyre mekanizmave dhe sa funksionon Këshilli i Nxënësve nëpër shkolla.

Alush Istogu, tha se në disa shkolla mësimi praktik funksionin më mirë e në disa shkolla funksionimi i tij është më i dobët. Fuqizimi i Këshillit të Nxënësve është i rëndësishëm sepse kjo do të ndikojë drejtpërsëdrejti në rritjen e cilësisë në shkollë, kjo me qëllim që nxënësit duke i parë përsëafërmi problemet në shkolla do të mund të ndikojë në zgjidhjen dhe përmirësimin e tyre. Ministria ka bërë një memorandum mirëkuptimi me kompani, në mënyrë që nxënësit të kryejnë praktikën profesionale, varësisht nga profilizimi i tyre. Kjo do të ndikojë që nxënësit pasi të jenë orientuar në praktikën profesionale, pas përfundimit të shkollës së mesme, do ta kenë më të lehtë të orientohen në tregun e punës.

Shpejtim Bulliqi, në diskutimin e tij, tha se rekomandimet e raportit janë të rëndësishme dhe ndikojnë në punën e Ministrisë, megjithatë ky raport nuk përfshin të gjitha rekomandimet. Do të ishte mirë të përfshihej në mesin e rekomandimeve edhe çështja e mësimdhënësve që punojnë nëpër shkolla dhe kanë probleme të ndryshme shëndetësore. Këta mësimdhënës përkundër gjendjes shëndetësore vazhdojnë të japin mësim, pasi nuk e kanë mbushur akoma moshën 65 vjeçare, dhe për shkak të mangësive të ndryshme, nuk mund të jenë shumë produktiv në punë. Do të ishte mirë që MASHT-i të shikojë mundësitë që në bashkëpunim me MPMS-në të gjejë një

formë kompensimi për këta mësimdhënës, pasi ata e rëndojnë buxhetin e Republikës së Kosovës dhe nuk kanë mundësi të japin maksimumin e tyre tek nxënësit për shkak të kufizimeve shëndetësore që u paraqiten. E dimë që është bërë një lloj decentralizimi nga Ministria tek DKA-të, po nuk ekziston një decentralizim i tillë sa i përket DKA-ve në shkolla dhe ky problem nuk paraqitet vetëm tek një Komunë, po në shumicën e tyre.

Ministria, përveç hartimit të politikave, është e obliguar që në terren të shikojë nivelin e zbatueshmërisë së tyre. Inspektorati i Arsimit fatkeqësisht është jofunksional, dhe ky është hendikepi më i madh i Ministrisë. Në këto kushte e ka të pamundur mbikëqyrjen e shkollave, dhe kjo mbikëqyrje mbetet ekskluzivisht në kompetencat e drejtorive të shkollave, ku shpesh ndodhë të ketë mbikëqyrje subjektive. Kërkoj nga Ministria funksionalizimin e inspektoratit, kjo do të mund të bëhej duke i fuqizuar këshilltarët pedagogjikë.

Ai ngriti edhe çështjen e numrit të madh të nxënësve nëpër klasë dhe tha se është i domosdoshëm ndryshimi i formulës së financimit që do të bëhej në bazë të rrethanave dhe specifikave të morfologjisë së terrenit.

Sa i përket përzgjedhjes së drejtorëve të shkollave, Bulliqi u shpreh se ky ligj ua mundëson drejtorëve të shkollave të mos sjellin rezultate të kënaqshme. Ministria ka dështuar me procesin e pilotimit dhe hartimit të kurrikulave. Është për keqardhje që ka ndodhur një gjë e tillë, përkundër financimit që është bërë, ndërsa sfidë tjetër mbetet çështja e mësimi praktik.

Mufera Shinik, tha se ka dërguar disa pika shtesë për plotësimin e raportit me rekomandimet për nivelin e zbatimit të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës. Këto rekomandime shtesë kanë të bëjnë me pasijen e nxënësve të komunitetit turk me fletoret e punës së lëndëve përkatëse, pasi ato mungojnë. Gjithashtu edhe tekstet për mësim të gjuhës shqipe. E përkrahi plotësisht shqetësimin e ngritur nga deputeti Bulliqi për mësimdhënien nga mësimdhënës që kanë probleme shëndetësore. Ajo diskutoi edhe për mungesën e psikologëve dhe pedagogëve në shumë shkolla të Kosovës, duke marr si shembull komunën e Prizrenit, ku vërehet një mungesë e psikologëve dhe pedagogëve, mandej në një shkollë të kësaj komune nuk ka asnjë psikolog apo pedagog, edhe përkundër faktit që shkolla ka më shumë se 1.600 nxënës.

Salih Morina, tha se gjatë vizitave në terren në lidhje me zbatueshmërinë e Ligjit për Arsimin Parauniversitar, Komisioni ka vërejtur disa probleme, shumica prej të cilave u ngritën nga anëtarët e Komisionit. Gjatë vizitës në Berlin shkëmbyem përvoja me Komisionin për Arsim atje dhe ato eksperiencia po mundohemi t'i përfshimë në punën tonë.

Lidhur me punën e inspektoratit, Morina tha se numri i inspektorëve që e mbulojnë fushën e arsimit nuk është i mjaftueshëm. Sa i përket çështjes së pedagogëve dhe psikologëve, nëse janë përfshirë në buxhet nga Ministria, do të ishte mirë që të implementohet, dhe ata të përfshihen në shkolla.

Besa Shahini, GIZ-i, tha se rekomandimet e dala nga monitorimi i ligjit, obligojnë Ministrinë për ndërmarrjen e masave për zbatimin e këtyre rekomandimeve, me qëllim të implementimit të ligjit në tërë vendin. Këto rekomandime kryesisht kanë të bëjnë me integrimin e komunitetit serb brenda kornizës ligjore të arsimit kosovar, tekstet shkollore dhe kurrikulat, komisionin për rishikim të teksteve, sistemin elektronik SMIA, vlerësimin e PSAK-ut dhe numrin e madh të nxënësve nëpër klasë.

Alush Istogu, tha se Komisioni ka bërë punë shumë të mirë me rekomandimet e nxjerra dhe ne si Ministri duhet të marrim masat e nevojshme për zbatimin e tyre. Sa i përket çështjeve të ngritura për mësimdhënësit me probleme shëndetësore, Ministria nuk merret me çështjen e pensioneve, mund ta aktualizojmë këtë çështje tek MPMS-ja.

Rreth numrit të nxënësve nëpër shkolla, Ministria ka hartuar udhëzimin administrativ që përcakton raportin nxënës- mësimdhënës, maksimumi i nxënësve nëpër klasë duhet të jetë 32. DKA-të në bashkëpunim me shkollat merret me koordinimin e numrit të nxënësve.

Pas debatit, Komisioni, njëzëri, nxori këtë

Rekomandim

I rekomandohet Kuvendit që të miratojë Raportin me rekomandime për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës.

4. Shqyrtimi i projektligjit Nr. 05/L-047 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-065, për të Drejtat e Autorit dhe drejtat e Përafërta

Nait Hasani, kryetar, tha se Komisioni lidhur me projektligjin nr. 05/L-047, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-065, për të Drejtat e Autorit dhe Drejtat e Përafërta, ka mbajtur disa takime dhe një dëgjim publik. Lidhur me këtë, ai tha se çështja që më tepër kërkon sqarim është çështja e mbrojtjes së lajmit të ditës, në mënyrë që të mbrohet lajmi dhe të mos keqpërdoret. Për këtë ka modele dhe praktika të ndryshme, ndërsa modeli i Austrisë se si e ka të rregulluar këtë çështje, do të ishte më i përshtatshëm për rrethanat tona.

Në dëgjimin e organizuar publik, lidhur me këtë projektligj, pjesëmarrja e grupeve të interesit ishte e vogël, andaj Hasani propozoi që të organizohet edhe një dëgjim publik, ku do të ftohen përfaqësues të mediave në vend, për të shprehur opinionet e tyre, në mënyrë që të gjithë se bashku të kontribuojmë në hartimin sa më të mirë të këtij ligji.

Salih Morina, tha se duke e parë ndërlidhjen që ka ky ligj me Raportin e Progresit dhe agjendën evropiane, është e rëndësishme që të ketë një dëgjim publik, ku do të diskutohej në detaje për pika të rëndësishme që përmban ky ligj, sidomos në aspektin e informimit, portaleve dhe lajmit në përgjithësi.

Agron Bajrami, tha se ky ligj do të mundësojë zgjidhjen e një prej problemeve kryesore që mediat e kanë mbrojtjen e informatës. Dhe me një rregullim ligjor, informatat e mbrojtura do të ndikojnë në një profesionalizim të mediave, duke e rritur kështu edhe cilësinë e tyre. Problemi kryesor qëndron tek prodhimi i lajmit, përderisa ka media që investojnë në kohë, njerëz dhe të ardhura për informimin sa më të denjë të opinionit, ka persona që i lansojnë këto lajme, përderisa të njëjtin lajm për një kohë shumë të shkurtër mund ta përdor dhe ta publikojë edhe dikush që nuk është aspak profesional në punën e tij. Modeli i ligjit të Austrisë është i mirë, pasi ky ligj përcakton afatet kohore brenda të cilave mund të përdoret një lajm. Hartimi i ligjeve në kuadër të nevojave të BE-së dhe kornizës ligjore evropiane është praktikë e mirë, mirëpo, do të ishte mirë të shikohen edhe rrethanat specifike në të cilat gjendet Kosova.

Valon Kashtanjeva, tha se çështjet e ngritura janë të drejta, mirëpo, nuk kanë të bëjnë më përjashtimin që lajmi i ditës nuk mbrohet me Ligjin mbi të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta. Duke filluar nga mbrojtja e informatës është e diskutueshme ajo se çfarë mund të konsiderohet i informatë, çka si lajm dhe çka si fakt. Kjo çështje është diskutuar gjatë dëgjimeve publike, paragrafi 1.8, tek Krijimet pa mbrojtje, etimologjia e përdorur është e njëjtë me atë të konventës kryesore të të drejtës së autorit, Konventës së Bernës. Në Kosovë lajmi mbrohet, mirëpo, ngjarjet e ditës dhe faktet, ato nuk mbrohen si e drejtë e autorit, pasi kjo do të ishte në kundërshtim me të drejtën kushtetuese të informimit të qytetarëve. Të gjitha krijimet e lajmeve, që mund të jenë krijime individuale dhe kreative mbrohen nga Ligji për të Drejtat e Autorit. Nuk mundet që ky ligj të përdoret për rregullimin e çështjeve tjera që janë aktuale në punën e mediave në përgjithësi, nisur nga përhapja e informatave të rrejshme e të ngjashme. Çështja e regjistrimit të portaleve, nuk mund të rregullohet po ashtu më këtë ligj, pasi ka ligje tjera specifike që merren me trajtimin e këtyre çështjeve. Ligji aktual për të Drejtat e Autorit, ka nene që janë të ngjashme më Ligjin e Austrisë për të Drejtat Autoriale, përjashtimisht nga neni 44 i këtij ligji, ku flitet edhe për kufizimet kohore, për përhapjen e lajmit. Mirëpo, gjatë diskutimeve të ardhshme, mund të shqyrtohet mundësia e përfshirjes së këtyre kufizimeve në Ligjin për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta në Republikën e Kosovës.

5. Të ndryshme

Në këtë pikë nuk pati diskutime.

Mbledhja përfundoi në orën 12:20

E përgatiti: Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit,

Nait Hasani